



## e Rahovecit

Nënshkruhet kontrata për ndërtimin e parkut solar prej 100 MW, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Konzorciumit të udhëhequr nga "Orllati Group"

Nënshkruhet kontrata ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe operatorëve të udhëhequr nga Konzorciumit "Orllati Group" me partnerë ndërkombëtarë e vendorë, për ndërtimin e parkut solar prej 100 MW, në territorin e Komunës së Rahovecit, në fshatrat Guri i Kuq dhe Kramovik. Konzorciumi i udhëhequr nga "Orllati Group" do të investojë mbi 70 milionë euro.



Nënshkruhet memorandum bashkëpunimi me vlerën e përgjithshme prej 661,228.00€

Nënshkruhet memorandum i projektit: "Ndërtimi i rrugës Sapniq - Nashpall". Vlera e përgjithshme e projektit është 661,228.00€. MMPHI-ja financon me 400,000.00€, ndërsa Komuna e Rahovecit e financon projektin me 261,228.00€.



## U themelua zyrtarisht Muzeu i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Drenoc

Në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal të Rahovecit, u shqyrtua dhe u miratua në mënyrë unanime propozim-vendimi për themelimin e MUZEUT TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS NË DRENOC - Shtëpia e Avdi (Sherif) Gashit.

Qëllimi i themelimit të muzeut të UÇK-së në Drenoc është grumbullimi, selektimi dhe ruajtja e dokumenteve dhe e gjësendeve të tjera të trashëgimisë së luajtshme me peshë të luftës së UÇK-së, në Komunën e Rahovecit, si celula e parë e UÇK-së.



## Nisin dëgjimet për planifikim të hershëm të buxhetit për vitin 2025

Janë mbajtur pesë dëgjime publike për planifikimin e hershëm të buxhetit. Dëgjimet u planifikuan dhe u mbajtën nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe me Zyrën për Informim.

Të pranishmit u informuan dhe u sqaruan për tërë atë që përmban Qarkorja e Parë Buxhetore e ardhur nga MF-ja për Komunën e Rahovecit, po ashtu, bashkëbiseduan edhe për ecurinë e përgatitjes së KAB-it komunal 2025-2026.





## Për tri net me radhë u mbajt Festivali Folklorik “Anadrinia jehon”

Festivali mbahet në datat 11,12 dhe 13 maj, në nderim të Betejës së Anadrinit të 12 majit 1998, të mobilizimit të liridashësve të kësaj treve në luftën çlirimtare dhe është pjesë e manifestimit përkujtimor e kulturor “Java e dëshmorëve” në komunën e Rahovecit.

Në këtë edicion garues morën pjesë 18 grupe artistike nga të gjitha trevat shqiptare.



## Përrurohet fusha sportive në Dejnë

Në hapësirën e ShFMU "Rudolf Walther" në Dejnë, u përruruan mjediset e reja sportive për futboll, basketboll dhe volejball, që do t'u shërbejnë të rinjve, nxënësve dhe të gjithë qytetarëve të fshatit për sport e rekreacion



## Vihet gurthemeli i terrenit sportiv në Dobidol

Në hapësirën e ShFMU "Rudolf Walther, paralelja e ndarë në Dobidol, u vendos gurthemeli për ndërtimim e terrenit sportiv, që do t'u shërbejë të rinjve, nxënësve dhe të gjithë qytetarëve të fshatit për sport e rekreacion.

Ky projekt është bashkëfinancim i Komunës së Rahovecit dhe UN - misioni në Kosovë, përkatësisht Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim dhe Organizatës “Advancing Together”.

